

VENDIM
Nr.70, datë 2.2.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ÇARSHOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Çarshovë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Çarshovë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.1644, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Çarshovë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Çarshovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Çarshovë, Gjirokastrë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
7-8	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
16-17	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
27-178	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
179-237, 239-275, 278-283, 290-292, 294, 298, 304-325, 328-331, 335, 339-401	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
238, 276-277, 284-289, 293, 295-297, 299-303, 326-327, 332-334, 336-338	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
402-406	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
407-410	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
614-630	Varrezat publike	Në pronësi

631-649	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
650-653, 660, 663, 670, 675-676, 684-685 (vetëm kanale të treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi